



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

MINISTRIA E MBROJTJES
AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE

MONITORIMI I SHPENZIMEVE PËR PROGRAMIN “EMERGJENCAT CIVILE ”

PËR 12-MUJORIN E VITIT 2024

Monitorimi i zbatimit të buxhetit të 12-mujorit të vitit 2024 për programin buxhetor “*Emergjencat Civile*” përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar.

Strukturat e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave, kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar në përputhje me planin strategjik të ecurisë së institucionit dhe të gjitha kërkesave ligjore.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të “*Emergjencave Civile*” në krahasim me planin e miratuar, të detajuar në nivel treguesi performance. Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor i mundëson institucioneve orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Me qëllim për të kontribuar në proceset bazë të misionit dhe objektivave të institucionit buxheti i “*Emergjencave Civile*”, do të mbështetet plotësisht në udhëzimet standarde të hartimit të buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës, por gjithashtu dhe monitorimin e realizimit buxhetor mbështetur mbi ato tregues të planifikuar gjatë hartimi të programit buxhetor afatmesëm. Ky raport zyrtar do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës AKMC dhe DPRMSH do të synojnë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecurisë së institucionit.

Programi buxhetor “*Emergjencat Civile*” administron dhe menaxhon fondet publike, sipas dy njësive shpenzuese të miratuara, konkretisht:

- 1) Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)
- 2) Rezervat e Shtetit (DPRMSH)

Buxheti vjetor fillestar për Programin “*Emergjencat Civile*” është **5 382 050 000 lekë**.

Buxheti vjetor i rishikuar për Programin “*Emergjencat Civile*” është **3 426 706 000 lekë**.

Realizimi i periudhës, për buxhetin e ndryshuar, paraqitet në vlerën **2 409 249 000 lekë**.

Objektivi 1: Zvogëlimi e humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis.

Tregues performance:

- Nderhyrje të ofruara në rast termeti
- Nderhyrje të ofruara në rast permbytje
- Nderhyrje të ofruara në rast zjarri

Objektivi 2 : "Rritja e stokut në mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore"

Tregues performance:

- Rritja e stokut të mallrave rezervë shteti të cilat do të përdoren për t'i ardhur në ndihmë familjeve të prekur nga fatkeqësitë natyrore me mallra rezervë shtetërore.

➤ **INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR**

Gjate vitit 2024, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka perfituar te ardhura jashte limitit ne kuader te projektit te NATO-s "NICS", në vlerën **10 009 526 lekë**, në zërin shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit llogaria ekonomike 602, kapitull 06, eshte realizuar transferimi i vleres 4 200 062 lek për shtetin e Gjeorgjise, si partner i këtij projekti i vili nuk është anëtar i NATO-s.

Fondet e miratuara për vitin 2024 për këtë program përbëjnë rreth 11.4% të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpenzohen për realizimin e objektivave.

Në total për periudhën 12-mujore 2024 kemi pakësim të buxhetit në shumën **1 955 344 000 lekë** në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601, kemi shtesë fondi në shumën 28 059 000 lekë

Në artikullin 602, kemi pakësim fondi në shumën 172 469 000 mijë lekë

Në artikullin 604, kemi pakësim fondi në shumën 18 000 000 mijë lekë

Në artikullin 605, kemi pakësim fondi në shumën 5 000 000 mijë lekë

Në artikullin 606, kemi shtesë fondi në shumën 1 686 000 lekë

Në artikullin 231 investime të brendshme (01) kemi pakësim fondi në shumën 196 890 000 lekë.

Në artikullin 231 investime të huaja (02) kemi pakësim fondi në shumën 1 592 550 000 lekë.

Në sistemin e thesarit SIFQ fondi për investime të huaja në vlerën **2 012 050 000** fond nuk celet në sistemin e thesarit dhe përbën tavanin e investimeve të huaja të cilat mund të përthith programin buxhetor "*Emergjencat Civile*" gjatë vitit buxhetor. Informacioni lidhur me realizimin e këtyre investimeve kapitull (02) realizohet nëpërmjet informacionit të gjeneruar nga sistemi AFMIS.

➤ **PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT**

1. Performanca financiare e programit buxhetor

Gjatë 12- muorit të vitit 2024, burimet financiare janë përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligj.

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 9% të buxhetit me ndryshime të miratuar për MM-në për periudhën raportuese.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 70.3%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korente, realizimi është në masën 84.1%,

Nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 98%,

- Shpenzime të tjera, në masën 81.2%,

Shpenzime Kapitale total, realizimi është në masën 61.9%,

Nga të cilat:

- Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm, realizimi është në masën 74%,
- Shpenzime Kapitale me financim të huaj, realizimi është në shumën 12%.

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i Brendshem, realizimi është në shumën 2 354 666 000 ose **78.3%**.
- Financimi i Huaj, realizimi është në shumën 50 383 000 lekë ose **12%**.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve:

Janë parashikuar 19 produkte me vlerë 3 426 706 000 lekë dhe janë realizuar 15 produkte me vlerë . 2 409 249 000 lekë (duke përfshirë edhe kap.02 dhe të ardhurat jashtë limitit kapitull 06) ose 70.3 %, të cilat paraqiten si më poshtë:

Në 000 lekë

Nr	Kodi I produktit	PRODUKTET	Buxheti 12-Mujor në (000/leke)	Realizimi 12-Mujori viti 2024	
				Realizimi 12-mujor në (000/lekë)	Në %
Total Shpenzime korrente AKMC			1,173,650	980,021	83.5%
1	91707AA	Mbrojtja e jetes njerzore, prone, trashigimise kulturore dhe pyetje ndaj zjarrit	391,651	384,957	98.3%
2	91707AB	Shtetas të ndihmuar, banesat e të cileve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme.	384,237	320,242	83.3%
3	91707AG	Shpenz.per marrjen e masave parandaluese,lehtesuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte te ndryshme npm blerjes se materialeve dhe sherb.te ndryshme,per mbrojtjen e jetes dhe prone se njerezve.	397,762	274,822	69.1%
Total Shpenzime per investime AKMC			2,064,911	1,259,823	61.0%
4	18AZ901	Masa parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese në disa bashki te vendit	1,559,895	1,152,536	73.9%
5	20AD102	Blerje softëare per permiresimin e sistemit te paralajmerimit te hershem	-	-	#DIV/0!
6	20AD103	Aplikimi I sistemeve te informacionit gjeografik (GIS) dhe Eëb GIS	-	-	#DIV/0!
7	20AD104	Blerje softëare baza e te dhenave te humbjeve nga fatkeqesite	39,096	39,096	100.0%
8	21AD501	Ndertim I stacioneve Hidro-meteorologjike	11,520	-	0.0%
9	22AG101	Bashkefinancim me projektet e huaja	-	-	#DIV/0!
10	22AG102	Bashkefinancim me projektet e huaja Roses	1,400	1,229	87.8%
11	22AG103	Bashkefinancim me projektet e huaja Flood North Albania	10,000	3,547	35.5%
12	22AG104	Bashkefinancim me projektet e huaja Local Drm	5,500	3,978	72.3%

13	22AG105	Bashkefinancim me projektet e huaja Sa Resilience	8,000	6,344	79.3%
14	M170411	Bashkefinancim, TVSH dhe taksa doganore	10,000	2,711	27.1%
		Investimet e huaja per AKMC	419,500	50,383	12.0%
		TOTAL AKMC	3,238,561	2,239,844	69.2%
		Total Shpenzime korrente DPRMSH	110,445	99,477	90.1%
1	91707AD	Stokut mallra ushqimore (rezerve materiale shteterore)	25,989	16,505	63.5%
2	91707AE	Stokut mallra industrial (rezerve materiale shteterore)	84,456	82,972	98.2%
		Total Shpenzime per investime DPRMSH	77,700	65,728	84.6%
3	M170521	Blerje mallra rezerve shteti ushqimore	11,700	-	0.0%
4	M170528	Blerje mallra rezerve shteti industrial	65,000	64,742	99.6%
5	21AD301	Blerje ushqim per bageti	1,000	986	98.6%
		TOTAL DPRMSH	265,845	230,933	86.9%
		TOTALI SHPENZIME KORRENTE	1,284,095	1,079,498	84.1%
		TOTALI SHPENZIME PER INVESTIME	2,142,611	1,325,551	61.9%
		TOTALI EMERGJENCAT CIVILE	3,426,706	2,405,049	70.3%

Vlera neto e shpenzimeve korrente dhe investime për vitin 2024 pa përfshirë kapitullin 06, paraqitet në shumën 2 405 049 000 lekë.

Shpenzimet e programit për investime

Shpenzimet e programit për investime (financim i brendshëm + financim i huaj),

Nga 12 projekte të parashikuara për investime, duke përfshirë edhe rialokimet gjatë vitit janë realizuar 10 projekt, realizimi faktik I të cilave është në vlerën **1 325 552 000** lekë ose 61.9%.

Analitikisht tabela e projekteve të investimeve të programit i bashkëlidhet këtij relacioni.

Projektet me financim të brendshëm për vitin 2024 janë realizuar në masën 61.9%, ky realizim ka ndikuar në rritjen e efikasitetit të shërbimit të strukturave të Emergjencave Civile dhe u arritën rezultatet e synuara, si më poshtë:

- U realizua perfundimi I investimeve ne disa bashki të vendit, duke synuar zvogelimin e mundesive per ndodhjen e fatkeqesive në keto zona.
- U përmirësua infrastruktura softëare per grumbullimin dhe perpunimin e te dhenave statistikore duke ndikuar ne krijimin e nje database me te sakte te fatkeqesive natyrore, zonave te prekura nga fatkeqesite dhe populates se ndikuar nga to.
- Rritja e kapaciteteve për përballimin e situatave emergjente me mallra industrial.
- U likuiduan detyrimet e përcaktuara në kontratat e projekteve me financim të huaj.

Gjatë vitit 2024 investimet e zbatuara nga njesite e veteqeverisjes vendore kane paraqitur problematika, te cilat kane te bejne me ecurine fizike dhe proceduriale te tyre. Vonesa te cilat kanë ndikuar në

realizimin në një nivel më të ulët të investimeve dhe rritjen e detyrimit për tu financuar në vitin pasardhës, sitatë e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në pakesimin e fondeve në dispozicion për financimin e projekteve të reja.

Disa nga projektet e investimit që kanë përfunduar në vitin 2024, mund të përmendim:

- Investime infrastrukturore në disa bashki të vendit si p.sh Rehabilitim emergjent i perroit të Gjerozes tek Fresku L=620 m, Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodren e Cfakës, pranë rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavijë, Përforcim terreni nga rrëshqitja në zonën e NJ. A Nr. 2, Nr. 4, Ishëm, Sistemim përroi, fshati Dobranj, Mbrojtja e lagjes Noneve nga gërryerja e përroit të Gostimës, fshati Polis Valë, Nj. A Shushicë, Ndërtim muri mbajtës në shkarjen e fshatit Krane, Ndërhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit, Rezervuar i Gjonçit, Prita malore në fshatrat Mësiçkë, Taç Poshtë, Rehabilitim i digës së rezervuarit Gjokaj 1etj.:

Me këto investim u arritën rezultatet e synuara:

- Permiresimi I infrastruktures ekzistuese me synim zvogelimin e riskut nga fatkeqesite natyrore.
- Përmirësimi I jetesës së populates në këto zona.
- Blerje softëare baza e te dhenave te humbjeve nga fatkeqesite.

Me këtë investim u arritën rezultatet e synuara:

- Ngritja e një sistemi informatic për grumbullimin dhe përpunimin e te dhenave te humbjeve nga fatkeqësia.
- Ulja e kohes se perpunimit te informacionit dhe rritja e saktësisë së tij.
- Perditesimi ne kohe sa me reale I informacionit.
- Blerje mallra rezerve shteti industrial

Me këtë investim u arritën rezultatet e synuara:

- Rritja e stokut reserve industrial duke ju perafuar nomenkaltures se kerkuar nga legjislacioni ne fuqi.
- Aftesi me e madhe reaguese me ndihma industrial ne rastin e fatkeqësive natyrore

Investimet e huaja të cilat janë evidentuar në këtë monitorim, kanë të bëjnë me fondet e AKMC-së në kapitull 02. Këto fonde edhe pse janë pjesë e buxhetit të programit Emergjencat Civile asnjëherë nuk janë aktive në SIFQ dhe si të tilla nuk monitorohen nga sistemi I thesarit. Realizimi I shprehur në monitorim, përfaqëson vlerën e shpenzimeve të realizuara gjatë periudhës 12 mujore në bankat e nivelit të dytë të cilat janë foonde të akorduara nga donatorët dhe perdoren në përputhje me kontratat e lidhura sipas aktiviteteteve të përcaktuara në grant Agreement. Në zbatim të Udhëzimit nr. 10 datë 12.07.2024 *“Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”*, lëvizjet e këtyre llogarive raportohen pranë Ministrisë së Financave dhe hidhen prej tyre në systemin AFMIS, Vlerat e shpenzimeve të pasqyruara nga ana e Ministrisë së Financave në AFMIS, janë vlera të cilat nuk shfaqen në SIFQ por gjenerohen në raportet e monitorimit të sistemit dhe për rrjedhojë pasqyrohen dhe ne tabelat tona të monitorimit.

Ndryshimet në buxhet

Buxheti i programit “Emergjencave Civile” ka pësuar disa ndryshime gjatë vitit 2024, si më poshtë vijon:

Shtesa

- 606 1 686 000 lekë (Shkresa nr. 2655/1 dt 12.03.2024 “Detajim I fondit te vecante” MF, VKM nr. 846 dt.26.12.2024 “Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore”
- 600 23 071 600 lekë (Shkresa nr.1488 dhe 1488/1 dt 14.08.2024 Njoftim transferim fondi per vitin 2024, Akti Normativ nr. 3 date 28.08.2024, Akti Normativ nr. 5 date 19.12.2024)
- 601 4 987 000 lekë (Shkresa nr.1488 dhe 1488/1 dt 14.08.2024 Njoftim transferim fondi per vitin 202, Akti Normativ nr. 3 date 28.08.2024, Akti Normativ nr. 5 date 19.12.2024)
- 604 150 000 000 lekë (Akti Normativ nr. 3 date 28.08.2024)

Pakësime

- 602 172 649 200 lekë (Shkresa nr.1488 dt 14.08.2024 Njoftim transferim fondi per vitin 2024, Akti Normativ nr. 5 date 19.12.2024)
- 604 168 000 000 lekë (Akti Normativ nr. 5 date 19.12.2024)
- 605 5 000 000 lekë (Akti Normativ nr. 5 date 19.12.2024)
- 231 (01) 196 890 000 lekë (Akti Normativ nr. 5 date 19.12.2024)
- 231 (02) 1 592 550 000 lekë (Akti Normativ nr. 5 date 19.12.2024)

INFORMACION MBI DETYRIMET E PRAPAMBETURA

Detyrimet e prapambetura për periudhën Janar-Dhjetor 2024, nga njësia shpenzuese AKMC janë në vlerën **195 671 839** lekë.

Me aktin normativ nr. 5 datë 19.12.2024 programit buxhetor “*Emergjencat Civile*” ju akorduan 150 000 000 lekë në llogarinë ekonomike 604, me qëllim likuidimin e një pjese të detyrimeve të prapambetura, krijuar ndër vite nga dosjet e qytetarëve të prekur nga fatkeqësitë natyrore, administruar nga AKMC. Kjo ka cuar në uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura, për të cilat do të ishte i domosdoshëm akordimi i një fondi shtesë me qëllim likuidimin total të tyre, kërkesë kjo e përfshirë në kërkesat buxhetore shtesë në kuadër të PBA-së 2025-202, por të pa miratuara me ligjin e buxhetit 115/2024 “*Për buxhetin e vitit 2025*”.

Performanca jo-financiare e programit buxhetor

Programi perfshin shpenzimet buxhetore për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”. Në ruajtjen dhe administrimin e mallrave që kalojnë në pronësi të shtetit nga kundërvajtjet

administrative dhe veprat penale si dhe zhvillon politika dhe strategji në fushën e parandalimit, gatishmërisë, përgjigjes dhe rehabilitimit nga emergjencat civile.

Qëllimi i këtij programi është mbrojtja e jetës, pasurisë, gjesë së gjallë trashigimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqesitë të ndryshme dhe ardhja në ndihmë e popullatës në gjendje të jashtëzakonshme si dhe rritja e stokut në mallra ushqimore dhe industrial dhe krijimi i kushteve optimale për administrimin menaxhimin dhe manipulimin e tyre.

Për këtë program janë parashikuar objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre. Për vitin 2024 objektivat kryesore janë:

1. Rritja e investimeve infrastrukturore me qëllim marrjen e masave parandaluese
2. Përmirësimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm
3. Rritja e kapaciteteve për ardhjen në ndihmë në rastet e fatkeqësive natyrore

Treguesit e performancës për këtë objektiva:

- Numri i investimeve të financuara
- Numri i sqytetarëve të ndihmuar në raste zjarri, përmbytje dhe tërmeti.
- Nr. I sistemeve paralajmëruese të vendosura në funksion
-

Performanca e treguesve të mësipër matet me bazë vjetore.

SHPENZIMET E REALIZUARA NGA TË ARDHURAT JASHTË PLANIT LIMIT (KAP. 6)

Në total shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë planit limit për 12-mujorin e vitit 2024 janë në shumën **4 200 062** lekë. Të analizuar si më poshtë:

Programi “**Emergjencat Civile**”, nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtës Civile në vitin 2024 në kuadër të projektit të financuar nga NATO ka arkëtuar **10 009 526 lekë** në kapitull 06 të cilat janë ndarë si më poshtë:

Në artikullin 602 “Mallra e shërbime të tjera”, në shumën **7 850 600 lekë** prej të cilave janë realizuar pagesa:

Transferim kuote për shtetin e Gjeorgjisë **4 200 060 lekë** si përfitues i fondeve por i cili nuk është anëtar i NATO-s.

Në artikullin 231 “Shpenzime për investime”, **2 158 921 lekë** prej të cilave vlera e shpenzuar për vitin 2024 është 0 lekë.

✚ ***Si konkluzion, në total realizimi i buxhetit për 12 mujorin e vitit 2024 për programin buxhetor “Emergjencat Civile” është në masën 70.3%. Rreth 12% të buxhetit total me ndryshime të programit e zënë investimet e huaja, vlerë e cila nuk është e celur në SIFQ dhe mosrealizimi i tyre ndikon në nivelin e realizimit total të programit.***

✚ ***Element tjetër i rëndësishëm me impakt në performancë është përdorimi i fondeve të AKMC-së në llogaritë ekonomike 604 dhe 231 nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, mos realizimi/realizimi i të cilave është përtej kompetencave ekzekutive të drejtëpërdrejta të AKMC-së . Lidhur me investimet e menaxhuara nga bashkitë është vënë re se një pjesë e mirë e tyre, proceset e prokurimit dhe lidhjes së kontratave i përfundojnë në fund të vitit buxhetor dhe për rrjedhojë realizimi i vitit aktual është i ulët, kërkesa për fonde më qëllim mbulimin e investimeve në proces për vitin e ardhshëm është më e lartë dhe fondet e disponueshme për financimin e projekteve të reja është e vogël.***

Në bazë të vlerësimit të të dhënave të realizimit të shpenzimeve buxhetore gjatë çdo muaji, është ndjekur sistematikisht dhe me përgjegjësi menaxhimi i fondeve buxhetore .

Problematikat e konstatuara gjatë këtij viti do të jenë objekt i vëmendjes dhe trajtimit me qëllim shmangien e përsëritjes së tyre në vijim.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
M I N I S T R I A E M B R O J T J E S
A G J E N C I A K O M B È T A R E E M B R O J T J E S C I V I L E
D R E J T O R I A E F I N A N C È S D H E S H È R B I M E V E M B È S H T E T È S E

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____. 2025

M E M O

Drejtuar : Z. Haki **ÇAKO**
Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Nëpërmjet: Znj. Mavina **SHIRA**
Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Përgatiti: Znj. Floriana **BRAJA**
Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës

Lënda: Dërgim i Monitorimeve dhe Shpenzimeve të Programit buxhetor “*Emergjencat Civile*”
për 12-mujorin e Vitit 2024.

Datë: 20.02.2025

I nderuar Zoti Drejtor i Përgjithshëm,

Në zbatim të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, Udhëzimit nr.14 datë 30.05.2023 “*Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në njësitë e qeverisjes Qendrore*” Udhëzimit Plotësues nr.1 datë 24.01.2024 “*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024*” kemi përgatitur raportet e monitorimeve për 12- mujorin e vitit 2024.

Bashkëlidhur dërgojmë në Ministrinë e Mbrojtjes tabelat analitike nxjerre nga sistemi informatik AFMIS, të shoqëruara me raportin e monitorimit të buxhetit për 12-mujorin e vitit 2024.

Lutemi aprovimin Tuaj.